

Vendim nr. 128 datë 13.06.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Genti Ibrahimi,	Anëtar
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 13.06.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 20 (A) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **AGRON GJOSHI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 30, datë 16.01.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2022-1313, datë 20.06.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për zhvillimin e gjykimit.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në janar të vitit 2011 kërkuesi Agron Gjoshi i është drejtuar Bankës Raiffeisen sh.a., dega Lushnjë për marrjen e një kredie me interesa të ulëta si punonjës i Policisë së Shtetit. Punonjësit e kësaj banke i kanë komunikuar se rezultonte debitor ndaj shoqërisë së kursim-kreditit “Qeha” sh.p.k. Pas interesimit pranë Unionit Shqiptar të Kursim-Kreditit, ai është

informuar se figuronte debitor ndaj kësaj shoqërie, ndërkohë që më pas i është lëshuar një vërtetim i datës 25.01.2011, sipas të cilit ai ka mbyllur detyrimet me unionin në këtë datë, ndërsa sipas një shkrese bashkëlidhur atij, të po asaj date, emërtuar “Veprim arke”, konfirmohet derdhja “cash” e vlerës 176,262 lekë.

2. Me pretendimin se nuk ka marrë asnjë kredi pranë shoqërisë së kursim-kreditit “Qeha” sh.p.k., kërkuarshi ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të cilin, në datën 20.06.2011, është regjistruar procedimi penal nr. 2662, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal (KP). Gjatë hetimeve paraprake, ndër të tjera, është administruar si provë akti i ekspertimit grafik i shkrimit e nënshkrimit nr. 5723, datë 05.07.2011, sipas të cilit në dokumentet “Kërkesë për kredi” e datës 10.08.2008 dhe “Kontratë Kredie” nr. ALTE-026041-005, datë 05.09.2008, shkrimi i emrit dhe mbiemrit të kërkuarshit, si dhe nënshkrimi (firma) nën të nuk janë shkruar prej tij, krahasuar kjo me modelet e paraqitura. Me vendimin e datës 02.11.2011, prokurori ka vendosur pezullimin e hetimeve për moszbulim të autorit të veprës penale, duke ia dërguar dosjen Drejtorisë së Policisë të qarkut Tiranë për veprime të mëtejshme hetimore, deri në zbulimin e autorit.

3. Në vijim, kërkuarshi i është drejtuar gjykatës me padi civile për shpërblimin e dëmit jopasuror. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 7845, datë 08.07.2013, ka vendosur pranimin e padisë, duke detyruar shoqërinë e kursim-kreditit “Qeha” sh.p.k. të dëmshpërblejë kërkuarshin në shumën 1,500,000 lekë si rezultat i shkakimit të dëmit jashtëkontraktor. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim në gjykatën e apelit shoqëria e kursim-kreditit “Qeha” sh.p.k.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 30, datë 16.01.2014, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë. Kundër këtij vendimi ka bërë rekurs kërkuarshi.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2022-1313, datë 20.06.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

6. Në datën 30.03.2023 kërkuarshi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

II

Pretendimet e kërkuarshit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

7.1. *E drejta e aksesit dhe e drejta për t'u dëgjuar*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pavarësisht se e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, duke vendosur mospranimin e rekursit, kishte detyrimin të arsyetonte vendimin e tij dhe të jepte arsyet se përse rekursi ishte i papranueshëm. Pretendimet e kërkuesit nuk janë paraqitur as në pjesën arsyetuese të vendimit dhe as nuk u është dhënë përgjigje.

7.2. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi arsyetimi i vendimit nga Gjykata e Lartë merr rëndësi të veçantë në këtë rast, duke qenë se qëndrimi i mbajtur nga gjykata e apelit është i kundërt me atë të gjykatës së shkallës së parë. Për më tepër, arsyetimi i gjykatës së apelit është alogjik, kontradiktor dhe jo në harmoni me rrethanat e faktet e çështjes dhe as me aktet provuese të ndodhura në dosje. Gjykata e apelit ka bërë një paraqitje selektive dhe të pavërtetë të fakteve, duke shtrembëruar rrethanat e çështjes, përveçse nuk është shprehur për atë që i është kërkuar, pasi nuk ka analizuar në asnjë moment faktin se përse dhe me kërkesë të kujt është lëshuar vërtetimi i datës 25.01.2011, sipas të cilit kërkuesi ka mbyllur detyrimet ndaj shoqërisë “Qeha” sh.p.k. kur pak kohë më parë figuronte debitor.

III

Vlerësimi i Kolegjit

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Për sa i përket përmbushjes së këtij kriteri, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm, për rrjedhojë konsiderohet se i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t’i drejtohej asaj.

12. Një ndër kriteret për të ushtruar ankim kushtetues individual është edhe legjitimitimi *ratione temporis*, i parashikuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, i cili përcakton afatin ligjor 4-mujor për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë nga konstatimi i cenimit.

13. Po kështu, sipas nenit 31, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, kur kërkesa, megjithëse është në kompetencë të Gjykatës dhe është paraqitur nga subjekti që legjitimohet, nuk është e plotë për ndonjë shkak të ndryshëm nga ato që parashikohen në nenin 27 të po këtij ligji, ajo ia kthen kërkuesit për plotësim, duke dhënë shkaqet e kthimit dhe afatin e plotësimit të saj.

14. Në datën 30.03.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, për të kundërshtuar vendimin nr. 30, datë 16.01.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimin nr. 00-2022-1313, datë 20.06.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor ndaj tij.

15. Kolegji, me vendimin e datës 29.05.2023, në lidhje me përmbushjen e kriterit paraprak *ratione temporis*, ka vlerësuar se kërkesa duhet t’i kthehet kërkuesit për plotësim, me qëllim paraqitjen e provave dhe të argumenteve lidhur me paraqitjen e ankimit kushtetues individual brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit e lidhur kjo me momentin e vënies në dispozicion ose të disponueshmërisë për palët të vendimit nr. 00-2022-1313, datë 20.06.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

16. Në datën 06.06.2023, pasi është njohur me vendimin e Kolegjit, kërkuesi ka sqaruar se vendimi nr. 00-2022-1313 datë 20.06.2022 i Gjykatës së Lartë nuk i është njoftuar ndonjëherë zyrtarisht me shkresë. Edhe te faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë, vendimi i publikuar për çështjen e tij është ai nr. 00-2022-1648, datë 15.06.2022 që u përket palëve të tjera ndërgjyqëse dhe jo vendimi nr. 00-2022-1313, datë 20.06.2022. Ndodhur në këto kushte kërkuesi është paraqitur personalisht në sekretarinë e Gjykatës së Lartë, e cila i ka vënë në dispozicion kopjen e vendimit nr. 00-2022-1313, datë 20.06.2022, duke vendosur në të edhe

shënimin për datën e dorëzimit në sportel të tij, konkretisht shënimin “*U paraqit sot në sportel, datë 01.02.2023*”.

17. Neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, fillimin e afatit ligjor 4-mujor për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë e lidh me momentin e konstatimit të cenimit, që në rastin e procesit gjyqësor, si rregull, është data e depozitimit në sekretarinë gjyqësore të vendimit të arsyetuar nga organi gjyqësor që përbën mjetin e fundit ankimor, përveçse kur kërkuesi provon se ka pasur mundësi efektive për t’u njohur me vendimin e arsyetuar në një datë të ndryshme. Në rastin konkret, vendimi gjyqësor më i fundit i kundërshtuar nga kërkuesi mban datën 20.06.2022, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 30.03.2023, ndërkohë që nuk ka asnjë të dhënë për datën e depozitimit në sekretarinë gjyqësore të vendimit të arsyetuar, ndaj në dukje kërkesa është jashtë afatit ligjor. Lidhur me këtë moment, si argument në mbështetje të plotësisht të këtij kriteri të pranueshmërisë, kërkuesi ka parashtruar se ka pasur mundësi të marrë dijeni efektivisht për këtë vendim vetëm në datën 01.02.2023, kur është paraqitur në sekretarinë gjyqësore të Gjykatës së Lartë dhe i është vënë në dispozicion vendimi i arsyetuar. Sipas kërkuesit, pikërisht nga kjo datë duhet të fillojë llogaritja e afatit ligjor 4-mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual.

18. Kolegji konstaton se në datën 01.06.2022 Gjykata e Lartë ka publikuar rregullisht në faqen e saj zyrtare njoftimin për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit për në datën 20.06.2022 dhe, më tej, në këtë datë, ka publikuar edhe informacionin për vendimin e marrë nga Kolegji Civil i saj për mënyrën e përfundimit të shqyrtimit të çështjes së kërkuesit. Në një datë të papërcaktuar vendimi i Gjykatës së Lartë është arsyetuar, ndërkohë që në faqen e saj zyrtare, për çështjen e kërkuesit, nga ana e sekretarisë gjyqësore të Gjykatës së Lartë gabimisht është publikuar një vendim që u përket palëve të tjera ndërgjyqëse dhe jo atij të marrë në çështjen e tij. Ndërkohë, duket që njoftimi elektronik i vendimit të arsyetuar për kërkuesin ka qenë i pamundur për sa kohë që ai nuk rezulton të ketë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*e-mail*). Në një situatë të tillë, Kolegji vëren se kërkuesit nuk i është dhënë informacioni i nevojshëm që ai të kujdesej për t’u njohur efektivisht me vendimin gjyqësor (vendimin e arsyetuar të Gjykatës së Lartë), që, sipas tij, i ka cenuar të drejtat kushtetuese. Duke mbajtur në konsideratë se vetëm njohja me vendimin e arsyetuar u mundëson palëve ta ankimojnë atë nëse e shohin të arsyeshme, si dhe individi nuk mund të mbajë një barrë të tepruar për shkak të gabimeve të administratës së gjykatës, Kolegji vlerëson se në rastin konkret, si moment i konstatimit të cenimit nga kërkuesi duhet të konsiderohet data 01.02.2023, kur ai pati mundësi efektive për të marrë dijeni për vendimin e arsyetuar objekt ankimi. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkesa përmbush edhe kriterin e legjitimitetit *ratione temporis*.

19. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta e aksesit, e drejta për t'u dëgjuar dhe standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor. Në lidhje me këto pretendime, Kolegji vëren se ato *prima facie* kanë natyrë kushtetuese, për rrjedhojë do të analizohen në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit dhe asaj për t'u dëgjuar

20. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pavarësisht se e ka shqyrtuar çështjen në dhomën e këshillimit, duke vendosur mospranimin e rekursit, kishte detyrimin të arsyetonte vendimin e tij dhe të jepte arsyet se përse rekursi ishte i papranueshëm. Pretendimet e kërkuesit nuk janë paraqitur as në pjesën arsyetuese dhe as nuk u është dhënë përgjigje.

21. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, e cila nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje gjyqësore përfundimtare për mosmarrëveshjen. Nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimin 14, datë 21.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në lidhje me shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë, Gjykata ka theksuar se është kompetencë e Kolegjeve të Gjykatës së Lartë të analizojnë nëse pretendimet e parashtruara në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit, duke vlerësuar kështu nëse çështja duhet të kalojë për shqyrtim në seancë gjyqësore. Në rast se kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk gjejnë mbështetje në aktet e administruara në dosjen gjyqësore, atëherë është në kompetencën e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimin nr. 6, datë 10.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Referuar dispozitave procedurale që zbatohen për shqyrtimin e rekurseve nga Gjykata e Lartë, rezulton se sipas nenit 472 të KPC-së: “1. Vendimet e shpallura nga gjykata e apelit dhe ato të shkallës së parë në rastet që parashikohen në këtë Kod mund të ankimohen me rekurs në Gjykatën e Lartë: a) për zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, të një rëndësie themelore për njehsimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; b) kur vendimi i ankimuar është i ndryshëm nga praktika gjyqësore e Kolegjit Civil ose praktika e njehsuar e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë; c) ka shkelje të rënda të normave

procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të procedurës së gjykimit, sipas nenit 467 të këtij Kodi.”.

24. Në rastin konkret, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje me rekursin e paraqitur nga kërkuesi dhe në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit Civil janë pasqyruar shkaqet mbi të cilat ka kundërshtuar vendimin e gjykatës së apelit. Pas vlerësimit të këtyre shkaqeve, Kolegji Civil ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqe ligjore nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së, duke vlerësuar se arsyetimi dhe përfundimi i arritur nga gjykatat e faktit është rrjedhojë e zbatimit të kërkesave të ligjit material dhe atij procedural. Sipas atij kolegji, nga gjykata e apelit janë respektuar normat procedurale; nuk ka shkelje të rënda procedurale, të cilat ndikojnë në dhënien e vendimit; palëve u është dhënë mundësia e mbrojtjes, të paraqesin prova ose të njihen me to, të debatojnë në lidhje me to, të shprehin qëndrimin e tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjes etj., duke u respektuar të gjitha parimet bazë të një procesi të rregullt ligjor; gjykata e apelit ka respektuar dispozitat e ligjit procedural dhe material dhe vendimmarrja e saj nuk bie në kundërshtim me praktikën e Gjykatës së Lartë; pretendimet e palëve që ngrenë çështje të vlerësimit të provave dalin jashtë juridiksionit të Gjykatës së Lartë. Sipas Kolegjit Civil, në analizë të provave të administruara në gjykim, si dhe pjesës arsyetuese të vendimeve, evidentohet se gjykata e apelit ka bërë një cilësim të drejtë të fakteve që lidhen me padinë e shpërblimit të dëmit jopasuror dhe se gjykata e apelit ka kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm të mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi gjyqësor në përputhje me nenin 14 të KPC-së, duke e zgjidhur drejt konfliktin midis tyre, në përputhje me ligjin.

25. Kolegji konstaton se pretendimet e kërkuesit në rekurs janë me natyrë ligjore, pasi kanë të bëjnë me fuqinë provuese të provave në përcaktimin e fakteve të mosmarrëveshjes. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke proceduar në dhomën e këshillimit, i ka verifikuar ato, në funksion të aksesit në gjykatë, dhe ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se shkaqet e paraqitura janë haptazi të pambështetura në ligj. Për rrjedhojë, Gjykata e Lartë ka vepruar në përputhje me funksionin kushtetues të juridiksionit rishikues që ka sipas nenit 141 të Kushtetutës.

26. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se vetëm fakti që rekursi është shqyrtuar në dhomën e këshillimit nuk është i tillë që të vërë në dyshim respektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për sa kohë që Kolegji Civil ka vepruar në përputhje me kompetencat e tij dhe me rregullat procedurale që gjejnë zbatim gjatë kësaj faze të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë. Në këtë kuptim, Kolegji konstaton se kërkuesit nuk i janë cenuar as e drejta e aksesit dhe as e drejta për t'u dëgjuar nga Gjykata e Lartë, për rrjedhojë pretendimi i tij është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit

27. Kërkuesi ka pretenduar se arsyetimi i vendimit nga Gjykata e Lartë merr rëndësi të veçantë në këtë rast, pasi qëndrimi i mbajtur nga gjykata e apelit është i kundërt me atë të gjykatës së shkallës së parë. Për më tepër, arsyetimi i gjykatës së apelit është alogjik, kontradiktor dhe jo në harmoni me rrethanat e faktet e çështjes dhe as me aktet provuese të ndodhura në dosje. Gjykata e apelit ka bërë një paraqitje selektive dhe të pavërtetë të fakteve, duke shtrembëruar rrethanat e çështjes, përveçse nuk është shprehur për atë që i kërkohet, pasi nuk ka analizuar në asnjë moment faktin se përse dhe me kërkesë të kujt u lëshua vërtetimi i datës 25.01.2011, sipas të cilit kërkuesi ka mbyllur detyrimet ndaj shoqërisë “Qeha” sh.p.k. kur pak kohë më parë figuronte debitor.

28. Gjykata ka theksuar në jurisprudencën e saj domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si garanci për të drejtën e procesit të rregullt ligjor. Sipas Gjykatës vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 11, datë 24.05.2022; nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Lidhur me rastet e vendimeve diametralisht të kundërta të dhëna nga gjykatat më të ulëta, jurisprudenca kushtetuese është shprehur se në këto raste Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, ka një rol të pazëvendësueshëm, nën dritën e të drejtave të aksesit dhe të ankimit në kuptimin substancial, si edhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor (*shih vendimet nr. 73, datë 16.12.2016; nr. 62, datë 23.09.2015; nr. 4, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Për shkak të këtij roli, Gjykata e Lartë, rast pas rasti, duhet t’u japë përgjigje problemeve ligjore që në praktikë lidhen me interpretimin e ligjit. Në të tilla raste, kërkuesi, nëse nuk merr përgjigje për pretendimet me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, i cenohet jo vetëm e drejta e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, por edhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimin nr.4, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Kolegji vëren se vendimi i mospranimit të rekursit të kërkuesit, që është dhënë nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit, nuk ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, pasi ky kolegji ka vepruar në përputhje me

kërkesat e ligjit procedural dhe nuk ka marrë attribute që i takojnë seancës gjyqësore. Edhe pse me arsyetim të kufizuar, vendimi i mospranimit të rekursit parashtron në mënyrë të plotë, në pjesën hyrëse të tij, shkaqet e rekursit. Për rrjedhojë, përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë tregon se i ka vlerësuar këto shkaqe, duke mos cenuar standardin kushtetues të arsytimit të vendimit.

31. Lidhur me argumentin e kërkuarit se procesi i rregullt ligjor është cenuar për shkak se në kushtet e dy vendimeve të gjykatave më të ulëta me qëndrime diametralisht të kundërta, Gjykata e Lartë duhet ta kalonte çështjen në seancë gjyqësore dhe ta zgjidhte atë përfundimisht, Kolegji vlerëson se ky fakt nuk përbën shkak ligjor, në vetvete, dhe të veçantë për shqyrtimin e rekursit të palëve në seancë gjyqësore.

32. Duke iu referuar jurisprudencës kushtetuese, në këto lloj rastesh, pra kur gjykatat e faktit kanë dhënë vendime diametralisht të kundërta, merr rëndësi përcaktuese natyra kushtetuese e pretendimeve që kërkuari ka ngritur në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Vetëm kur pretendimet në rekurs synojnë verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e *subsidiaritetit*, duhet të ushtrojë funksionin e saj për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në seancë gjyqësore dhe t’u japë përgjigje të arsyetuara pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs (*shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Për sa i përket pretendimit të kërkuarit se arsyetimi i vendimit të gjykatës së apelit është alogjik, kontradiktor dhe jo në harmoni me rrethanat e faktet e çështjes dhe me aktet provuese të ndodhura në dosje, Kolegji vëren se vendimi i kundërshtuar i përmbush kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsytimin e tij, pasi ai nuk rezulton të jetë alogjik, kontradiktor ose i paqartë në përmbajtjen dhe vlerësimin e bërë, për rrjedhojë pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

34. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.